

LIGJ
Nr. 40/2013

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9867, DATË 31.1.2008 “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE PËR TREGTIMIN NDËRKOMBËTAR TË LLOJEVE TË RREZIKUARA TË FAUNËS DHE TË FLORËS SË EGËR”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVEND
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9867, datë 31.1.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për tregtimin ndërkombëtar të llojeve të rrezikuara të faunës dhe të florës së egër”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 9, emërtimi “Inspektorati i Peshkimit” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati që mbulon fushën e peshkimit”.

Neni 2

Në nenin 32 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Paragrafi i parë i pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“Kur shkeljet e përmendura më poshtë nuk përbëjnë veprë penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me dënim kryesor me gjobë:”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Krahas dënimit kryesor me gjobë, mund të vendosen edhe dënimet plotësuese të heqjes së lejes ose sekuestrimit të parashikuar në nenin 34 të këtij ligji.”.

Neni 3

Neni 35 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 35

Dokumentimi

1. Procesi i inspektimit dhe dënimit të shkeljeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

2. Të drejtën e vendosjes së gjobës për kundërvajtjet administrative, të parashikuara në nenin 31 të këtij ligji, e kanë inspektorët e Policisë Pyjore, inspektorati që mbulon fushën e peshkimit.”.

Neni 4

Neni 36 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 36

Shqyrtimi dhe ankimi

Shqyrtimi, marrja e vendimit përfundimtar dhe ankimi ndaj tij bëhen në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 5

Neni 37 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 37

Pagimi i gjobës

Gjoba paguhet brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të formës së prerë. Pas kalimit të këtij afati, personi paguan një kamatë në masën 2 për qind të vlerës së gjobës për çdo ditë për një afat deri në 30 ditë. Me kalimin e këtij afati zbatohen dispozitat në fuqi për kundërvajtjet administrative.”.

Neni 6

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.2.2013

Shpallur me dekretin nr. 7999, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani